



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 41, datë 03.12.2020

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE ZHVILLIMI DHE NDËRTIMI  
BRENDA ZONAVE TË MBROJTURA DHE ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E  
TURIZMIT

Në mbështetje të neneve 28, pika 1, dhe nenit 29 të Kodit të Procedurave Administrative, neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 19, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Për territoret ku ka plane të përgjithshme vendore në fuqi, përfshirë edhe ato të përmendura në Nenin 45, shkronja “a”, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, kërkesat për leje zhvillimi dhe ndërtimi në Zonat e Mbrojtura dhe Zonat me Përparësi Zhvillimin e Turizmit, të merren në shqyrtim nga autoritetet vendore, duke respektuar Planet e Përgjithshme Vendore përkatëse.
2. Për territoret ku nuk ka plane të përgjithshme vendore në fuqi, kërkesat për leje zhvillimi dhe ndërtimi në Zonat e Mbrojtura dhe Zonat me Përparësi Zhvillimin e Turizmit, të merren në shqyrtim nga autoritetet vendore, vetëm për kategoritë e përcaktuara në Vendimin Nr. 1, datë 30.07.2015, të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”, i ndryshuar.
3. Në çdo rast, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit të vijojnë procedurat, sipas pikës 1 dhe

2 të këtij vendimi, duke respektuar dispozitat e legjislacionit të posaçëm mbi mbrojtjen e mjedisit dhe vetëm pas marrjes së:

- a) mendimit pozitiv nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për Zonat e Mbrojtura; ose
  - b) mendim pozitiv nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për Zonat me Përparësi Zhvillimin e Turizmit;
  - c) aktit të përputhshmërisë nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit për Zonat e Mbrojtura, si dhe për Zonat me Përparësi Zhvillimin e Turizmit, i cili më pas i njoftohet Këshillit Kombëtar të Territorit.
4. Çdo leje e miratuar nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit, në kushtet e mungesës, apo dhënes së një përgjigje negative, në secilin prej akteve të përmendura në shkronjat “a” “b” dhe “c”, të pikës 3, të këtij vendimi, do të konsiderohet nul dhe e pavlefshme.
5. Procedurat e parashikuara në këtë vendim, të zbatohen nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit, për të gjitha kërkesat për kryerjen e punimeve dhe ndërtimin e objekteve, me përjashtim të atyre që klasifikohen si “zhvillime komplekse”, referuar nenit 19, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, shqyrtimi dhe miratimi i të cilave, është kompetencë e Këshillit Kombëtar të Territorit.
6. Kërkesat për kryerjen e punimeve mbi bazën e një “deklarate paraprake për kryerjen e punimeve” do të paraqiten dhe shqyrtohen pranë autoriteteve vendore të zhvillimit të territorit.
7. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe autoritetet vendore të zhvillimit të territorit për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

E D I R A M A



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

